



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Drejtoria e Edukimit Parauniversitar**

Nr. 5378/Prot.

Tiranë, më 7. 10. 2011

**LËNDA: NEVOJAT PËR TRAJNIMIN E MËSUESVE DHE DREJTUESVE NË  
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

**DREJTUAR: DREJTORIVE ARSIMOR RAJONALE  
ZYRAVE ARSIMORE**

Në zbatim të Urdhërit Nr 110, datë 09.03.2011 si dhe të Rregullores për “Sistemin e Akreditimit të Programeve të Trajnimit”, bashkëlidhur do të gjeni nevojat për Trajnim të Mësuesve dhe Drejtuesve të Arsimit Parauniversitar.

SKËNDER UKU

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 23, AL 1001, Tiranë  
Tel: +355 4 2225832

Email: [ivejsiu@mash.gov.al](mailto:ivejsiu@mash.gov.al)  
Web site: [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
DREJTORIA E EDUKIMIT PARAUNIVERSITAR  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Nr. 5378 Prot.

Tiranë, më 14. 10. 2011



**NEVOJAT PËR TRAJNIM TË MËSUESVE DHE DREJTUESVE NË ARSIMIN  
PARAUNIVERSITAR PËR PERIU DHËN 2011-2013**

Procesi i trajnimit të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore është konsideruar si prioritet i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe nga viti në vit po i kushtohet një vëmendje e veçantë. MASH-i ka iniciuar dhe nxitur zbatimin e strategjive të reja, profesionale dhe bashkëkohore për këtë proces kaq të rëndësishëm.

Trajnimi i mësuesve dhe drejtuesve është i lidhur me faktin se mësuesit janë pjesë e institucioneve arsimore të të nxënit, pjesë e komunitetit, pjesë e shoqërisë, aktorë të reformave dhe që ata kanë nevojë për mbështetje në punën e tyre. Sot, të nxënit kërkon përtëritje të të menduarit, përvetësim të njohurive specifike rreth mjedisit, shëndetit dhe qytetarisë si dhe promovim të vlerave dhe qëndrimeve në shoqëri. Trajnimi i mësuesve e drejtuesve, ka pasur parasysh këto veçori dhe është përpjekur të aftësojë sistemin arsimor për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të sotme të të nxënit.

Në përmbushje të Urdhrit nr. 110 datë 09.03.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Rregullores për Sistemin e Akreditimit të Programeve të Trajnimit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit- IZHA në bashkëpunim me Drejtorinë e Edukimit Parauniversitar (MASH), kanë punuar për identifikimin dhe grumbullimin e nevojave për zhvillim profesional të mësuesve dhe drejtuesve. Duke pasur parasysh se ky proces është kompleks, është marrë mendimi i sa më

shumë aktorëve që kontribuojnë në sistemin arsimor parauniversitar. Për këtë është diskutuar me specialistë të MASH, Institutit të Zhvillimit të Arsimit, Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, Drejtorive Arsimore Rajonale, Zyrave Arsimore si dhe disa agjencive që kanë kontribute në këtë fushë.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas prioriteteve fushat dhe tematikat kryesore të identifikuara si nevoja për zhvillim profesional të personelit arsimor për periudhën 2011-2013:

## **1. Kurrikula**

- Korniza kurrikulare.
- Udhëzuesi Kurrikular.
- Kurrikula bërthamë dhe zbatimi në shkollë.
- Kurrikula me zgjedhje, llojet e saj, zbatimi në shkollë.
- Programet lëndore, risitë, zbatimi në klasë.
- Projektet kurrikulare lëndore ose ndërlëndore, organizimi, zbatimi, vlerësimi i nxënësve.
- Projektet kurrikulare në nivel klasash ose shkolle, organizimi, zbatimi, vlerësimi i nxënësve.
- Standardet e fushave të të nxënësve.
- Përdorimi i standardeve të arritjes për arsimin parashkollor.
- Zhvillimi i kurrikulës shkollore të arsimit profesional dhe atij social kulturor
- Skeletkurrikulat lëndore në nivel shkolle për shkollat profesionale
- Përshtatja e objektivave të kurrikulës për fëmijët me aftësi të kufizuara

## **2. Dokumentacioni shkollor (Ligje, Urdhra, udhëzime, rregullore etj)**

- Ligji i arsimit parauniversitar.
- Ligji i arsimit profesional.
- Dispozitat Normative.
- Udhëzimi për vlerësimin e nxënësve në gjimnaz dhe në shkollat profesionale.
- Udhëzimet për fillimin e vitit shkollor.
- Kriteret për vlerësimin e teksteve shkollore.
- Rregullorja e kualifikimit të mësuesve.
- Rregullorja e kualifikimit të drejtorëve të institucioneve arsimore.
- Rregullorja për zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit
- Rregullorja e DAR/ZA-ve.
- Akte të tjera nënligjore që dalin gjatë kësaj periudhe.

### **3. Drejtimi dhe menaxhimi i institucionit arsimor**

- Standardet e drejtorit.
- Drejtori si lider pedagogjik.
- Etika dhe komunikimi i drejtorit.
- Politikat arsimore, planifikimi dhe vendimmarrja.
- Menaxhimi i institucionit dhe menaxhimi financiar.
- Legjislacioni, organizimi i institucionit arsimor (shkollë, kopsht).
- Vlerësimi i jashtëm dhe vetëvlerësimi i institucionit.
- Vlerësimi i mësuesve nga drejtori.
- Plani afatmesëm i institucionit.
- Plani vjetor i institucionit.
- Raporti vjetor i institucionit.
- Ngritja dhe funksionimi i bordit të institucionit arsimor.
- Fuqizimi i partneritetit social dhe biznesit me shkollat profesionale.

### **4. Mësimdhënia dhe nxënia (Pjesa e parë: aspekte metodologjike)**

- Plani vjetor lëndor i mësuesit.
- Plani ditor i mësuesit në shkolla dhe kopshte.
- Metoda, teknika, strategji mësimore me në qendër nxënësin
- Metoda dhe teknika që nxisin të menduarit kritik dhe krijues
- Hartimi i objektivave të arritjeve të nxënësve për kapitull.
- Hartimi i minitesteve për rendimentin e orës mësimore.
- Hartimi i minitesteve për objektivat e arritjeve të nxënësve për kapitull.
- Metoda të vetëvlerësimit të nxënësve.
- Metoda integruese në arsimin parashkollor
- Hartimi i testeve për kapitull dhe vlerësimi i nxënësve.
- Planifikimi dhe zhvillimi i përsëritjes për një ose disa kapituj.
- Detyrat e shtëpisë në dy ose tri nivele.
- Portofoli i nxënësit.
- Përgatitja e materialeve mësimore në profilet e ndryshme në arsimin profesional
- Mësimdhënia dhe të mësuarit mbi “sipërmarrjen” në arsimin e përgjithshëm dhe në arsimin profesional

### **5. Mësimdhënia dhe nxënia ( Pjesa e dytë: aspekte pedagogjike)**

- Zhvillimi moshor i nxënësve
- Motivimi i nxënësve.

- Menaxhimi i klasës.
- Menaxhimi i konflikteve me nxënësit dhe ndërmjet nxënësve.
- Mësimdhënia dhe nxënia për nxënës me aftësi të kufizuara.
- Mësimdhënia dhe nxënia në klasat e bashkuara.
- Mësimdhënia dhe nxënia për nxënësit me vështirësi në të nxënë.
- Mësimdhënia dhe nxënia në arsimin parashkollor.
- Përdorimi i gjuhës së shenjave në komunikimin me fëmijët që nuk dëgjojnë ose që nuk dëgjojnë fare gjatë procesit mësimor.
- Përdorimi i alfabetit “Brail” për fëmijët që nuk shikojnë.

## **6. Mësimdhënia dhe nxënia (Pjesa e tretë: TIK)**

- Përdorimi i TIK në mësimdhënie dhe nxënie.
- Përdorimi i pajisjeve DEMO në lëndë të ndryshme.
- Përdorimi i programeve kompjuterike për përgatitjen e demonstrimeve praktike në lëndë të ndryshme.
- Përdorimi praktik i laboratorit virtual.
- Përdorimi i laboratorit profesional të TIK në shkollat profesionale.
- Përdorimi i metodave interaktive online.
- Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik në shkolla.

## **7. Mësimdhënia dhe nxënia (Pjesa e katërt: Aftësitë kroskurrikulare)**

- Kuptimi mbi kompetencat themelore.
- Lidhja ndërmjet njohurive teorike lëndore me përvojat e përditshme të nxënësve dhe me dukuri e ngjarje të botës reale.
- Përdorimi i matematikës në lëndët e tjera.
- Lidhja ndërmjet njohurive dhe koncepteve të një lënde me lëndë të tjera.
- Kultivimi të nxënësit i aftësive ndërkurrikulare:
  - të komunikimit në gjuhën amtare dhe atë zyrtare;
  - të menduarit kritik;
  - të menduarit krijues;
  - të zgjidhjes së situatave problemore;
  - të punës së pavarur individuale;
  - të punës me grupe të vogla brenda në klasë dhe jashtë saj;
  - të sipërmarrjes;
  - të marrëdhënieve sociale.
- Trajtimi si temë ndërkurrikulare i:
  - të drejtave të fëmijëve;
  - ndërgjegjësimit për mjedisin;
  - zgjidhjes paqësore të konflikteve;
  - i dimensionin europian.

## 8. Të tjera

- Standardet e përgjithshme të mësuesit dhe ato të mësuesit lëndor.
- Mentori.
- Normat e etikës dhe të sjelljes së mësuesit.
- Bashkëpunimi me prindërit e nxënësve.
- Zhvillimi i kompetencave dhe shprehive praktike të mësuesve që japin modulet e praktikave mësimore.
- Edukimi për karrierë në arsimin bazë.
- Veprimtaritë jashtshkollore.
- Roli i psikologut dhe bashkëpunimi i mësuesit me të.